



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 3080/1 Prot.

Fier, më 07/04 2023

VENDIM
Nr. 03 datë 07/04 / 2023

PËR
AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE
PËR ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 3 pika 5, nenit 77 pika 1, nenit 78 pika 1 dhe 4, nenit 79 dhe nenit 88 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KQZ) "*Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*", në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Fier,

VENDOSA:

- 1- Të caktoj vendet publike me akses dhe hapësirë të bollshme për publikun për afishimin e materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor politik, të cilat i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor, për fushatën zgjedhore për Zgjedhjet Vendore të datës 14 Maj 2023, sipas listës bashkangjitur këtij vendimi.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Kundravajtjeve Administrative, Emergjencave Civile dhe IVMT, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Infrastrukturës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier, të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Fier.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Armando SUBASHI
me autorizim
Zv. Kryetari

Andius OLLDASHI





**LISTA E AMBIENTEVE PUBLIKE ME AKSES TË PLOTË DHE HAPËSIRË TË
BOLLSHME PËR PUBLIKUN
PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE
PËR ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

- Zyra me një ndalesë, Bashkia Fier (One Stop Shop);
- Këndet e njoftimeve pranë zyrave të Gjendjes Civile pranë Njësive Administrative 1;2;3;4;
- Këndet e njoftimeve në ambientet e Njësive Administrative , Bashkia Fier:
 - Njësia Administrative Qendër;
 - Njësia Administrative Mbrostar –Ura;
 - Njësia Administrative Portëz;
 - Njësia Administrative Cakran;
 - Njësia Administrative Libofshë;
 - Njësia Administrative Levan;
 - Njësia Administrative Frakull;
 - Njësia Administrative Topojë;
 - Njësia Administrative Dërmënas;